

KULTURA 2022

GUSHT



Nr.8

kultura.gov.al



MBYLLET FAZA E PARË E "ART NË HAPËSIRA PUBLIKE", 139 PROPOZIME PËR 18 VENDNDODHJE

Plot 139 propozime nga artistë shqiptarë e të huaj janë paraqitur në edicionin e parë të Konkursit Ndërkombëtar "Art në Hapësira Publike". Në datën 18 gusht ka përfunduar faza e parë, ajo e dorëzimit të projektideve për realizimin e 18 veprave në hapësira publike, si në rrethrotullime, mbikalime, institucione publike etj., që shtrihen nga Veriu në Jug, Tiranë, Shkodër, Kavajë, Lushnjë, Gjirokastrë etj. Pas një pune të vëmendshme të kolegjiut, aplikimet që përmbushin kërkesat e fazës së parë, i kalojnë për gjykim jurisë së konkursit, për të vlerësuar dhe shpallur fituesit e kësaj faze. Në fazën e dytë pritet detajimi i projektideve, detajimi i preventivave, i kohës së realizimit, grupet e

ËSHTË NJË PROJEKT MADHOR, QË DO TË QOHET PËRPARA NË BASHKËPUNIM ME INSTITUCIONE TË TJERA QENDRORE DHE LOKALE, DUKE RESPEKTUAR AMBIENTIN, FIZIONOMINË URBANISTIKE DHE ARKITEKTURËN LOKALE, SI DHE RREGULLAT E QARKULLIMIT RRUGOR.

punës etj. Art në Hapësira Publike është një nga nismat më të reja të qeverisë shqiptare për kulturën, për nxitjen e krijimtarisë artistike, për përmirësimin e imazhit të hapësirave publike, por edhe për promovimin e së bukurës dhe estetikës. Kjo nismë, me një zë të përcaktuar në buxhetin e Ministrisë së Kulturës, prej 200 milionë lekësh ka për qëllim pasurimin e hapësirave publike me vepra origjinale të autorëve të ndryshëm, si dhe integrimin e artit si formë e shprehjes në hapësira urbane e sociale në vendin tonë. Ky është rasti kur natyra, arkitektura dhe arti shkrihen me njëra-tjetrën, duke krijuar jo vetëm atraksione vizuale, por edhe pika të reja identifikimi dhe referimi.

PARKU I ARTIT, PËRFUNDON RESTAURIMI I GODINËS SË ISH-KINOSTUDIOS



Ka përfunduar faza e rehabilitimit dhe restaurimit të pjesës së degraduar të godinës monumentale të ish-Kinostudios. Pas fazës së pajisjes, artistët do të gjejnë aty salla montazhi, zhvillimi fotografie, regjistrimesh, workshopesh... për të zhvilluar krijimtarinë e tyre. Po ashtu, po ndryshon faqen edhe oborri i pasmë, që rikthehet në jetë duke u bërë funksional për banorët dhe komunitetin artistik. Ky restaurim është pjesë e projektit të ngritjes së Parkut të Artit, faza e parë e të cilit u mbështet nga një financim prej 1 milion eurosh nga Bashkimi Europian, për të vijuar me fonde të buxhetit të shtetit prej 100 milionë lekësh.

RESTAUROHET HAMAMI I SHEK XVIII NË DURRËS



Si pjesë e programit EU4Culture, Hamami i vjetër po i nënshtrohet restaurimit dhe rihetësimit, për t'u shndërruar në një tjetër pikë turistike në Durrës. Tërmeti i vitit 2019 la pas dëmtime edhe në këtë objekt të shek. XVII-XVIII, i cili ndodhet në qendër të qytetit, shumë pranë monumenteve-simbol të tij. Ky objekt, ndër dëshmitë e pakta të arkitekturës publike të kësaj periudhe u përfshi në listën prioritare të programit të rindërtimit të objekteve-monument kulture, të dëmtuara nga tërmeti, EU4Culture. Pas përfundimit të strukturës, restaurimit, riveshjes së dyshemesë, do të shtohet edhe elementi digjital për të treguar historinë e objektit.

RESTAUROHET GODINA E TEATRIT TË KUKULLAVE, RUHEN ELEMENTET ORIGJINALE

E dëmtuar nga tërmeti, por edhe nga koha, godina që dikur u ngrit për të qenë Parlamenti i parë Shqiptar dhe shndërruar gjatë dikaturës në teatër kukullash, po i nënshtrohet restaurimit. Duke ruajtur vlerat e saj historike dhe arkitektonike, kjo ndërtesë do të vazhdojë t'i shërbejë kulturës, falë ndërhyrjes restauruese, mundësuar nga programi i Bashkimit Europian, EU4Culture dhe zbatuar nga UNOPS-i. Ndërhyrjet prekin çdo element të ndërtesës, që nga dyshemeja, muret, çatia, dyert e dritaret, kulla e skenës, duke e rikthyer atë në jetë. Edhe pjesët anësore, të zëna nga biznese private, do të vendosen në shërbim të godinës. Për të ruajtur elementet origjinale, janë shfrytëzuar materiale arkivore të kohës.



ARKEOLOGJI, GËRMIMET NË LIN NXJERRIN NË DRITË NJË VENDBANIM

7500-vjeçar. Zbulohet një vendbanim 7500-vjeçar në Lin! Pranë fshatit Buqezë në Lin, po kryhen gërmime arkeologjike për zbulimin e vendbanimit "palafit", që sipas arkeologëve daton 7500 vjet më parë. Sipërfaqja e vendbanimit prehistorik




mendohej të jetë rreth 35.000 m². Projekti shqiptaro-zviceran "LIN 3", është një bashkëpunim i Institutit të Arkeologjisë-ASA-Akademia e Studimeve Albanologjike me Universitetin e Bernës, Zvicër, dhe me mbështetjen e laboratorëve

të Universitetit të Oxford-it, Angli, në bashkëpunimin e Ministrisë së Kulturës dhe Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Korçë. Sipas drejtuesit shkencor të projektit, Adrian Anastasi, janë zbuluar elemente drusore, që dëshmojnë për mënyrën e ndërtimit dhe arkitekturës. Gjatë gërmimeve po dalin në dritë vegla pune prej stralli, enë të ndryshme qeramike, fragmente kocke kafshësh dhe janë marrë kampione sedimentologjike për analiza në laboratorë. Gërmimet dhe studimet e mëtejshme pritet të nxjerrin rezultate të rëndësishme për arkeologjinë dhe historinë tonë.

"NJË DET ME LIBRA", MBAHET NË DURRËS FESTIVALI VEROR

Përgjatë 5 ditëve Durrësi u shndërrua në kryeqytetin veror të librit. Me mbështetjen e Ministrisë së Kulturës, Shoqata e Botuesve Shqiptarë dhe Bashkia Durrësi i dhanë udhë festivalit "Një det me libra". Një nga ato ngjarje të shumëpritura, që bashkë me panairin e librit sjellin më pranë lexuesit debatin letrar, por edhe autorë të preferuar. Në ceremoninë e hapjes së festivalit, më 17 gusht, ishte e pranishme edhe ministrja e Kulturës, Elva Margariti, e cila premtoi më shumë bashkëpunim në fushën e librit.



Ajo u shpreh se Shqipëria ka kaluar periudha të vështira, si tërmeti e pandemia, megjithatë është koha për të investuar më shumë te libri. Gjatë ditëve të festivalit, Durrësi mblodhi botues, shkrimtarë, përkthyes e studiues, që ndanë me lexuesin ide dhe probleme me të cilat përballet libri jo vetëm në Shqipëri.